



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:270306

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876165

KPPP.nr.2083/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Bega” SH.P.K., me numër unik identifikues 811052993 me seli në Ferizaj, me pronarë P.B. kundër debitorit “UDA” SH.P.K., me numër unik identifikues 811349697, me adresë në rr. “Kemajl Kokshi” Doganaj, Kaçanik, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.311/2023 të datës 10.10.2023 të Përmbaremit Privat Mubarak S. Shumolli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datës 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “UDA” SH.P.K., dhe Urdhri P.nr.311/2023 i datës 10.10.2023 i Përmbaremit Privat Mubarak S. Shumolli, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Bega” SH.P.K., ka lëshuar Urdhrit Përmbaremore P.nr.311/2023 të datës 10.10.2023 me të cilin e ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës me nr. 58-20 të datës 23.07.2020 me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 617.00€ me kamatë ligjore prej 8% deri në pagesën e plotë si dhe shpenzimet e procedurës së përmbaremit përmes bllokimit të të gjitha llogarive bankare dhe regjistrohet, konfiskohet dhe shitet pasuria e debitorit si në sende të luajtshme po ashtu edhe paluajtshme të tjera në tërë masën pasurore të debitorit.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbaremit, brenda afatit ligjor debitori ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrit përmbaremore me arsyetimin se me kreditorin në mënyrë

të vazhdueshme ka qenë në marrëdhënie kontraktuale dhe të njëjtit i ka përmbushur të gjitha obligimet ndaj tij, mirëpo për faturën e cila është objekt i kësaj procedure përbarimore është njoftuar se nuk do të kryhet pagesa për shkak të metave, respektivisht deri sa të bëhen përmisime dhe të ndërrohen dy pajisje që nuk kanë funksionuar dhe që kishin garancion në mënyrë që më pas të behet mbyllja e borxhit. Tutje thekson se kreditori nuk i është përgjigjur ftesës së debitorit për përmisimin e këtyre të metave. Gjykatës, i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar dhe meqenëse ekziston kontest lidhur me përmbushjen e detyrimit nga ana e kreditorit në lidhje me pajisjet çështja të konsiderohet kontestuese.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata vlerëson se Urdhri Përbarimor P.nr.311/2023 i datës 10.10.2023 bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht Faturën me nr. 58-20 të datës 23.07.2020 në lartësi prej 617.00€, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në to janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori,

janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Për më tepër, gjykata gjen se faturat mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Ndërsa, lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim në lidhje me të metat e mallrave të cilat kanë qenë objekt i faturës, debitori me asnjë provë nuk ka vërtetuar se këto të meta i kishte deklaruar tek kreditori me rastin e nënshkrimit të faturës dhe se faturën e ka nënshkruar pa ndonjë vërejtje. Andaj, në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2083/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.